



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

VENDIM
I
KËSHILLIT DREJTUES
NR. 6, DATË 26.11.2018

Sot, më datë 26.11.2018, në orën 14:00, në selinë e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), sipas njoftimit të bërë nga Drejtori Ekzekutiv, u mbledh Këshilli Drejtues i ADISA-s, ku ishin të pranishëm anëtarët si më poshtë:

- Znj. Xaira Shurdha (Kryetar);
- Znj. Delina Nano (Anëtar);
- Znj. Vilma Gjata (Çausholli) (Anëtar);
- Znj. Eda Spahiu (Anëtar).

Nuk ishin të pranishëm në mbledhje 3 (tri) anëtarë të Këshillit Drejtues:

- Znj. Aulona Mersini (Anëtar);
- Znj. Romina Kuko (Anëtar);
- Z. Toni Gogu (Anëtar).

Në mbledhje morën pjesë gjithashtu Drejtori Ekzekutiv i ADISA-s, Z. Lorin Ymeri dhe Znj. Edlira Cimbi, Drejtore e Drejtorisë së Administrimit të Brendshëm.

Pasi u mbledh dhe diskutoi për të vendosur lidhur me pikat e rendit të ditës dhe në mbështetje të nenit 17 dhe 22 të Ligjit Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në strukturën organizative të ADISA-s, bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Të miratojë planin e veprimit për zhvillimin dhe shtrirjen e ADISA-s për periudhën 2019-2021, bashkëngjitur këtij Vendimi.



3. Të miratojë kalimin e një automjeti të ADISA-s, në kapital të Kryeministrisë.
4. Të miratojë emërimin e Znj. Sara Kapoli, si sekretare të Këshillit Drejtues të ADISA-s.
5. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Xhane Senolli

